

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 35 paragrafi 1 alineja 6 dhe nenit 37 paragrafi 1 alineja 14 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019), më 28.12.2021, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, komunikimin ndërmjet të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta realizojë me Kryetarin e Këshillit gjyqësor dhe anëtarin e Këshillit gjyqësor, në kryerjen e funksioneve të tyre dhe kompetencave të cilat dalin nga Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për gjykatat, si dhe Rregulloren gjyqësore, Rregulloren e punës së Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Rregulloren e punës së Gjykatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

A r s y e t i m

Në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 19.10.2021 lidhur me pikën nga Rendi i ditës “Shqyrtimi dhe diskutimi i kërkesës së dorëzuar dhe të nënshkruar nga Anëtarë i Këshillit gjyqësor – Koordinator për Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Hanif Zendeli”, për dorëzimin e të dhënave, u nxor Konkluzion i cili më 20.10.2021 është dorëzuar në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas dorëzimit të Konkluzionit të theksuar, të nxjerrë në Seancën e përgjithshme, Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut i është dorëzuar Urgjencë me nr. 03-1571/2 të datës 25.11.2021, për të njëjtën kërkesë për dorëzimin e të dhënave, të nënshkruar nga anëtari i Këshillit gjyqësor – Koordinator për Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Hanif Zendeli.

Duke e marrë parasysh Urgjencën e dorëzuar për të njëjtën kërkesë, pa u vepruar mbi Konkluzion e nxjerrë në Seancën e përgjithshme të datës 19.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, caktoi Seancë të përgjithshme më 28.12.2021, në të cilën morën pjesë Kryetarja e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Pavlina Crvenkovska, Zëvendësi i kryetares së Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Mr. Selim Ademi dhe Anëtarë i Këshillit gjyqësor – Koordinator për Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Hanif Zendeli.

Në Seancën e përgjithshme, u diskutua mbi Konkluzionin e nxjerrë të datës 19.10.2021 dhe mbi përfundimin e diskutimit nga ana e anëtarëve të Seancës së përgjithshme u pranuan një pjesë e arsyetimeve dhe sugjerimeve të përfaqësuesve nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

U vendos që Konkluzioni i datës 19.10.2021 të ri definohet dhe njëzëri të miratohet Konkluzioni si në kumtimin.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme